



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 80-të të mbajtur më 18.01.2023 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-4715/1, datë 14.10.2021, e formuar pas kërkesës së dorëzuar për moszbatim të vendimit për heqjen e objektit të ndërtuar pa leje, **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm.

Lënda me numër 12-4715/1 nga data 14.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 14.10.2021 është dorëzuar kërkesë nga një parashtrues i njohur për moszbatim të vendimit për heqjen e objektit të ndërtuar pa leje dhe është formuar lënda me numër 12-4715/1 datë 14.10.2021.

Në denoncim dyshohet se për shkak të marrëdhënies së ngushtë të kryetarit të komunës _____ me investitorin e objektit të ndërtuar pa leje, nuk është vepruar sipas Vendimit të plotëfuqishëm për heqjen e objektit të ndërtuar pa leje nr. _____ datë 25.10.2019.

Për verifikimin e pretendimeve dhe vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në çështjen e hapur, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për mbledhjen e informacionit në ///.

Nga ana e komunës është dorëzuar përgjigje ndaj kërkesës, në të cilën raportohet se me kërkesën e datës 12.09.2019, inspektori i autorizuar ndërtimor i Komunës _____ ka kryer inspektim në vend dhe ka përgatitur një raport në bazë të të cilit është nxjerrë Vendimi për largimin e ndërtimit nr. ____/ 2019 nga 25.10.2019. Inspektori i autorizuar i ndërtimit ka përgatitur konkluzion

për lejen e ekzekutimit të datës 29.04.2021. Një konkluzion i tillë është ankuar nga ekzekutivi _____, pas së cilës Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në shkallën e dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse e ka anuluar konkluzionin për leje përbarimi dhe ka dhënë rekomandime për veprime të mëtutjeshme. Në vazhdim, thuhet se duke vepruar sipas këtyre rekomandimeve, inspektori i autorizuar ndërtimor pranë Komunës _____ i ka dërguar njoftim personit _____ se Vendimi nr. ____/2019 e datës 25.10.2019 është përbarimore, në të cilën i jepet një afat prej 30 ditësh për heqjen e objektit të ndërtuar pa leje nga vetë përbaruesi. Meqenëse objekti pa leje **medhe** ende nuk është hequr plotësisht, ekzekutuesit do t'i dërgohet një urdhër ekzekutimi me një afat shtesë prej 15 ditësh për ta hequr vetë objektin. Gjithashtu thuhet se nëse objekti nuk hiqet edhe pas këtij afati, komuna do ta largojë objektin me shpenzimet e përbaruesit. Njëkohësisht, në përgjigje, komuna informon se inspektori i autorizuar ndërtimor i ka dorëzuar kryetarit të komunës me datë 25.11.2022 kërkesë për hapjen e procedurës së prokurimit publik për një kompani përbarues që do të largojë objektin e ndërtuar pa leje sepse komuna nuk kanë makineritë dhe stafin e duhur për të njëjtën gjë.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK vlerësoi se ka vepruar dhe ka marrë masa organi kompetent për çka nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev